

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. FATOS LULO

03/23/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës degjimore më datë 21.03.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Lulo, bazuar në ligjin nr.84/2016, sot, më datë 23.03.2018, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Fatos Lulo, gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjykuese e kryesuar nga znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Etleda Çiftja relatore dhe znj. Brunilda Bekteshi anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë, vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.